

PASOJAT E LUFTËS SË PARË BOTËRORE NË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË NË HISTORI E KOHËS SË RE

NGA

GËZIM MAREVCI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

QERSHOR, 2021

EKSPOZE E TEMËS

PASOJAT E LUFTËS SË PARË BOTËRORE NË KOSOVË

Mentor: Prof. Dr. Bujar Dugolli

Kandidati: Gëzim Marevci

Fillimi i Luftës së Parë Botërore e kishte gjetur Kosovën të pushtuar nga Serbia dhe Mali i Zi, dhe me shumë pasoja si rezultat i këtij pushtimi ndërsa ato u shtuan dhe më shumë me fillimin e Luftës së Parë Botërore. Pasojat e Luftës së Parë Botërore si veçori e veçantë në ndonjë temë nuk është trajtuar, prandaj qëllimi i kësaj teme të Masterit është ofrimi i rezultateve të reja për problemin në fjalë, duke u bazuar në burime të botuara e të pabotuara. Në këtë mënyrë do të trajtohen të gjitha pasojat politike, ekonomike, shoqërore, fetare dhe kulturore-arsimore si edhe qëndresa luftarake e shqiptarëve të Kosovës kundër këtyre pasojave gjatë Luftës së Parë Botërore.

Motivi për të sjellë të dhëna të reja për këtë çështje në të gjitha pasojat ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturo-arsimore, ishte motivi kryesor për të hulumtuar dhe studiuar këtë problem dhe për ta sjellë në formën e një punimi të masterit. Studimet për këtë temë kanë qenë të pakta, prandaj jemi munduar që të plotësohet ky boshllëk e kjo mangësi për këtë temë, në mënyrë që të ndriçohen në mënyrë të argumentuar të gjitha pasojat e Luftës së Parë Botërore në Kosovë.

Punimi për të qenë më i qasshmë e kemi ndarë në katër kapituj dhe në njësi më të vogla (tituj dhe nëntituj). Kapitullin e Parë do ta fillojmë me nisjen e Luftës së Parë Botërore, e cila edhe pse kishte filluar me heret në Kosovë filloi të ndihej që në fillim të saj për shkak të rekrutimit ushtarak të cilin e filloj Serbia për nevojat e saj të luftës. Vazhdimi i luftës solli rrethana të reja, por shkak së shqiptarët filluan qëndresën e tyre siç ishte Kryengritja e Shkurtit e vitit 1915 e organizuar nga Hasan Prishtina. Më pastaj lufta solli tërheqjen e ushtrisë serbe nëpër trojet shqiptare, ku pati luftime nga të dy anët. Veç kësaj, do të flasim edhe për vrasjen e njërit ndër krerët kryesorë të Kosovës, Isa Boletinit.

Në Kapitullin e Dytë, do të trajtojmë zonën austro-hungareze të pushtimit dhe administrimin e saj. Rekrutimi ushtarak ishte fillimi i parë i veprimit të këtyre pushtuesëve, ku më pastaj vazhdoj me burgosjen, internimin e vrasjen e të gjithë atyre që kundërshtonin normat e tyre

ligjore. Në këtë kapitulli do të flasim edhe për gjendjen e arsimit dhe fillimin për herë të parë të shkollave shqipe në Kosovë, gjithashtu edhe rolin e prijësve shqiptarë për hapjen e këtyre shkollave edhe pozitën ekonomike të shqiptarëve në këtë zonë.

Në Kapitullin e tretë vazhdojmë me shtjellimin e zonës bullgare të pushtimit edhe administrimin e saj. Edhe në zonën bullgare të pushtimit, rekurimi ushtarak ishte veprimi i saj i parë. Më pastaj edhe ajo filloi masat e saj të dhunës si vrasje, internimin, burgosje madje edhe të krerëve kryesorë të Kosovës si Hasan Prishtina e Idriz Seferi si dhe rekuizimin e punën e dhunshme për shumicën e shqiptarëve. Gjithashtu do flasim për gjendjen e gruas shqiptare, si dhe gjendjen e keq të arsimit, të cilën bullgarët nuk e lejonin edhe e luftonin me të gjitha mjetet.

Në Kapitullin e Katër dhe të fundit do të flasim për qëndresën e shqiptarëve kundër pushtueseve austro-hungarezë e bullgarë si dhe pjesëmarrjen e tyre në Kryengritjen e Toplicës. Gjithashtu do të flasim edhe për rolin e dy udhëheqësve kryesor gjatë Luftës, si Hasan Prishtina e Azem Galica si dhe rolin e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, duke e përfunduar këtë kapitull të fundit me ripushtimin serb edhe përfundimin e Luftës.

Studimi mbështetet në shtyllat bartëse të metodologjisë shkencore. Metoda hulumtuese, e aplikuar në këtë temë është në fillim hulumtimi historik si një nga metodat më të rëndësishme të hulumtimit historik që përfshinë mbledhjen e të dhënave dhe sistemimin e tyre me qëllim vlerësimin objektiv të hipotezave mbi ngjarjet dhe rrjedhat e atyre ngjarjeve historike. Pas kësaj, metodë tjetër që kam përdorur është ajo e analizës, përshkrimit dhe metoda krahasimtare. Për fund, dua të falënderoj Mentorin tim Profesorin Bujar Dugollin, jo vetëm për ndihmën dhe udhëzimet e dhëna por edhe për lirinë akademike të ofruar gjatë përgatitjes dhe finalizimit të projektit.